Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
Thesari / Trezor / Treasury

Raporti vjetor financiar

Buxheti i Republikës së Kosovës

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, kati 10 , Rr. "Nëna Terezë" -10000 Prishtinë-Kosovë
Telefon/Faks: +381 38 200 34 026 / +381 38 212 362
www.mf-rks.org

Përmbajtja **2**
Përkufizimet **5**

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës 6
Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës 7
Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës 8

Shënimet e pasqyrave financiare **9**

Shënimi 1 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël 9
Shënimi 1.1 Baza e përgatitjes 9
Shënimi 1.2 Politikat e kontabilitetit 9
Shënimi 1.3 Subjekti raportues 10
Shënimi 1.4 Pagesat e bëra nga palët e treta 10
Shënimi 1.5 Paratë e gatshme 10
Shënimi 1.6 Rikthimet e të dalave (pagesave) nga viti paraprak 10
Shënimi 1.7 Valuta raportuese 10
Shënimi 1.8 Shumat raportuese 10
Shënimi 1.9 Data e autorizimit 10
Shënimi 2 Doganat 11
Shënimi 3 Administrata Tatimor 12
Shënimi 4 Të hyrat vetanake të komunave 13
Shënimi 5 Të hyrat vetanake të organizatave qendrore buxhetore 14
Shënimi 5.1 Të hyrat nga Licencat 14
Shënimi 5.2 Të hyrat nga Participimet 14
Shënimi 6 Të hyrat e dedikuara të AKP-së 14
Shënimi 7 Grantet e përcaktuara të donatorëve 15
Shënimi 8 Grantet për përkrahje të buxhetit 16
Shënimi 9 Huazimet e Jashtme 16
Shënimi 10 Huazimet e Brëndshme 16
Shënimi 11 Depozitat 17
Shënimi 12 Gjobat dhe tarifat 17
Shënimi 12.1 Taksat administrative 18
Shënimi 13 Interesi 19
Shënimi 14 Dividentat 19
Shënimi 15 Financimi i njëhershëm i AKP-së 19
Shënimi 16 Kthimi i huadhënjeve nga Ndërmarrjet Publike 19
Shënimi 17 Të hyrat tjera 20
Shënimi 17.1 Të hyrat nga viti i kaluar 20
Shënimi 18 Rroga dhe paga 21
Shënimi 19 Mallra dhe shërbime 22
Shënimi 20 Shpenzimet për shërbimet komunale 23
Shënimi 21 Subvencionet dhe transferet 24
Shënimi 22 Shpenzimet kapitale 25
Shënimi 23 Pagesat e borxhit 26
Shënimi 24 Huadhënjet për ndërmarrjet publike 26
Shënimi 25 Pagesat për anëtarsim në IFN 26
Shënimi 26 Kthimet e Fondeve të Depozitave 27
Shënimi 27 Para të gatshme 27

Shënimi 28 Krahasimet buxhetore 28
Shënimi 29 Fondet në Bankën Qendrore të Kosovës....28
Shënimi 29.1 Letrat me Vlerë për Qeverinë 29
Shënimi 29.2 Depozitat e afatizuara në BQK 29
Shënimi 30 Fondet në bankat komerciale 29
Shënimi 31 Fondet në bankë komerciale – NLB Prishtina 30
Shënimi 32 Para të gatshme në tranzit....31
Shënimi 33 Llogarit e Ambasadave 31
Shënim 34 Para të gatshme në dorë (arka) 32
Shënimi 35 Fondi i përcaktuar i donatorëve....33
Shënimi 36 Të hyrat vetanake 34
Shënimi 37 Të hyrat e dedikuara të AKP-së....34
Shënimi 38 Fondet tjera 34

RAPORT I BUXHETIT TE KONSOLIDUAR TË KOSOVËS PER VITIN 2012 35

Pranimet....36
Pagesat....37

Klasifikimi i shpenzimeve sipas karakterit funksional dhe ekonomik....38
Klasifikimi i shpenzimeve të granteve sipas karakterit funksional dhe ekonomik....38

ANEKSI 1. Krahasimi i ndarjeve buxhetore 2012.... 39
ANEKSI 2. Shpenzimet sipas organizatave buxhetore 48
ANEKSI 3. Raporti i granteve te përcaktuara të donatorëve 2012....57
ANEKSI 4. Të hyrat vetanake për bartje 59
ANEKSI 5. Huadhënjet për ndërmarrje publike.... 61
ANEKSI 6. Raporti i pasurive jofinanciare te organizatave buxhetore me vlerë mbi 1000€.... 61
ANEKSI 7. Raporti i pasurive jofinanciare te organizatave buxhetore me vlerë nën 1000€ 63
ANEKSI 8. Raporti i stoqeve të organizatave buxhetore 65
ANEKSI 9. Raporti i faturave të papaguara sipas organizatave buxhetore.... 67
ANEKSI 10. Paraja në tranzit.... 69
ANEKSI 11. Të dhënat për transferet nga fondi rezervë 70
ANEKSI 12. Të dhënat e punësimit....71
ANEKSI 13. Raporti për pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPP-së 73

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
Thesari / Trezor / Treasury

D e k l a r a t ë
e
Ministrit për Financa
dhe
Drejtorit të Thesarit

Të nderuar-a,

Kemi kënaqësinë dhe nderin e veçantë, që bashkangjitur me këtë deklaratë, të paraqesim Raportin Financiar për vitin 2012. Ky raport është në përputhje të plotë me kërkesat dhe përkufizimet juridike të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Finanacave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/l-221, si dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, të bazuar në para të gatshme.

Konsiderojmë dhe fuqishëm besojmë se ky raport financiar pasqyron në mënyrë të saktë dhe të drejtë financat dhe transaksionet financiare të Institucioneve të Kosovës nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Fondet në Mirëbesim, Grandet e Përcaktuara të Donatorëve dhe Huamarrjet për vitin fiskal 2012.

Duke qenë se ky raport financiar paraqet pasqyrat formale financiare të Republikës së Kosovës, për ne është një kënaqësi dhe privilegj i veçantë që t`i dorëzojmë Qeverisë për miratim dhe dorëzim Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky raport do t`i dorëzohet edhe Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

Me respekt,

Ramadan Avdiu
Zv. Ministër i Financave

Datë: 20 Mars 2013

Fatmir Plakiqi
Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Datë: 20 Mars 2013

Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e shënuara më poshtë në këtë pasqyrë financiare do të kenë kuptimin e përshkruar si në vijim:

0	Shumat < 500 Euro
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BEP	Banka Ekonomike e Prishtinës
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
BKT	Banka Kombëtare Tregëtare
BpB	Banka Private e Biznesit
BQK	Banka Qëndrore e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësore i Kosovës
FKK	Fondi i Konsoliduar i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSDK	Fondi për Sigurinë e Depozitave të Kosovës
GPD	Grantet e përcaktuara të donatorëve
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LL.B	Llogaritë Bankare
LMFPP	Ligji mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPLL	Libri i Përgjithshëm i Llogarive-SIMFK
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NLB	NLB Prishtina
NP	Ndërmarrjet Publike
OB	Organizata Buxhetore
PCB	Pro Credit Bank
PR	Prishtinë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RBI	Reiffaisen Bank Internacional
RBKO	Reiffaisen Bank Kosova
Shënim	Sqarim i zërave
SBA	Stand By Agreement
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNKSP-IPSAS	Standardet Nderkomëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
SPF-GFS	Statistikat e Përgjithshme Financiare
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Kosovës

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012

		2012		2011		2010	
	Shënim	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €	Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	Pagesat nga palët e treta '000 €
PRANIMET							
Tatimi							
Doganat	2	842,787	-	826,592	-	699,385	-
Administrata Tatimore	3	251,151		231,360	-	194,218	-
		1,093,939	-	1,057,952	-	893,603	-
Të hyrat vetanake							
Komunat	4	59,448	-	55,621	-	52,028	-
Organizatat qendrore buxhetore	5	44,835	-	59,912	-	48,451	-
		104,283	-	115,534		100,480	
Të hyrat e dedikuara							
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	6	16,248	-	-	-	-	-
		16,248					
Grantet dhe ndihmat							
Grantet e përcaktuara të donatorëve	7	11,322	5,493	8,968	4,642	15,342	4,394
Grantet për përkrahje të buxhetit	8	37,417	-	19,240		30,000	
		48,738	5,493	28,208	4,642	45,342	4,394
Huamarrja							
Huamarrja e jashtëme	9	93,677		5,076		22,093	
Huamarrja e brendëshme	10	73,313		-		-	
		166,990		5,076		22,093	
Pranimet tjera							
Fondi i depozitave	11	1,338	-	957	-	577	-
Gjobat dhe tarifat	12	39,845	-	43,393	-	33,337	-
Interesi bankar	13	0	-	1,631	-	11,718	-
Dividentat	14	45,000	-	60,000	-	85,000	-
		86,183	-	105,981		130,632	
Financimi i njëhershëm i AKP-së	15	28,934	-	-	-	-	-
Kthimi i huadhënjeve nga NP	16	4,000	-	-	-	-	-
Tjera	17	1,300	-	502	-	2,358	-
Gjithsej Pranimet		**1,550,615**	**5,493**	**1,313,252**	**4,642**	**1,194,508**	**4,394**
PAGESAT							
Operacionet							
Rrogat dhe pagat	18	409,245	-	388,303	-	316,200	-
Mallërat dhe shërbimet	19	172,482	5,493	161,591	4,642	167,156	4,394
Shërbimet komunale	20	21,560	-	20,388	-	19,527	-
		603,287		570,282		502,884	
Transferet							
Subvencionet dhe transferet	21	280,317	-	256,476	-	253,484	-
Shpenzimet kapitale	22						
Prona,impiantet, pajisjet,transferet		554,813	-	531,290	-	459,272	-
Pagesat tjera							
Pagesa e Borgjit	23	21,416	-	11,491	-	10,083	-
Huadhënjet për ndermarrjet publike	24	15,000	-	30,000	-	60,000	-
Pagesa për anëtarësim në IFN	25	1,050	-	-	-	169	-
Kthimet nga fondet e depozitave	26	190	-	922	-	1,632	-
Gjithsej Pagesat		**1,476,072**	**-**	**1,400,462**	**-**	**1,287,523**	**-**
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		74,543	5,493	(87,209)	4,642	(93,015)	4,394
Para të gatshme në fillim të vitit	**27**	203,629		290,838		383,853	
Para të gatshme në fund të vitit	**27**	**278,171**	**5,493**	**203,629**	**4,642**	**290,838**	**4,394**

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012

Buxheti i miratuar në bazë të parave të gatshme

(Klasifikimi i pagesave sipas klasifikimit ekonomike)

			2012				2011	2010
	Shënim		Buxheti fillestar A '000 €	Buxheti përfundimtar B '000 €	Realizimi C '000 €	Ndryshimet buxhetore D=C-B '000 €	Realizimi '000 €	Realizimi '000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME								
Tatimi			1,120,062	1,127,500	1,093,939	(33,562)	1,057,952	893,603
Të hyrat vetanake			115,204	113,919	104,283	(9,636)	115,534	100,480
Dividenta			35,000	45,000	45,000	-	60,000	85,000
Të hyrat nga huamarrjet			176,000	178,000	166,990	(11,010)	-	-
Të Tjera		*	98,340	132,282	127,743	(4,539)	69,842	99,506
Gjithsej Pranimet		**	**1,544,606**	**1,596,701**	**1,537,955**	**(58,747)**	**1,303,328**	**1,178,589**
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME								
Rrogat dhe pagat			407,476	415,285	407,706	(7,578)	385,033	311,417
Mallërat dhe shërbimet			175,490	193,161	169,362	(23,799)	156,559	162,635
Shërbimet komunale			22,790	23,445	21,558	(1,887)	20,376	19,516
Subvencionet dhe transferet			281,680	292,475	280,120	(12,355)	256,166	252,679
Shpenzimet kapitale			616,879	623,551	550,245	(73,306)	528,186	455,344
Rezervat			4,596	361	-	(361)	-	-
Të tjera		***	39,000	37,466	37,466	-	41,491	70,252
Gjithsej Pagesat	28	****	**1,547,912**	**1,585,744**	**1,466,457**	**(119,287)**	**1,387,810**	**1,271,842**

Shënim: (*) Përfshihen:Të hyrat e dedikuara të AKPsë (16,248,000 €),Grantet për mbështetjen e buxhetit (37,417,000 €), Gjobat dhe tarifat (39,845,000 €),Financimi i njëhershëm i AKP-së (28,934,0000 €),Kthimi i huadhënjeve nga NP(4,000,000 €) dhe Tjera (1,300,000 €).

(**) Në totalin e pranimeve nuk janë përfshirë pranimet nga GPD në shumë 11,322,000 Euro dhe pranimet e depozitave ne shumë 1,338,000 Euro.

(***) Përfshihen:Huadhënjet për KEK-un (15,000,000 €) ,pagesat e borxhit (21,416,000 €) dhe pagesa për anëtarësim në IFN (1,050,000 €)

(****) Në totalin e pagesave nuk janë përfshirë pagesat nga GPD në shumë 9,426,000 Euro dhe kthimet nga fondet e depozitave ne shumë 190,000 Euro.

Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012

	Shënim	2012 Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	2011 Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €	2010 Menaxhuar nga Qeveria e Kosovës '000 €
Pasuritë financiare në para të gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	29	73,697	89,326	48,796
Letrat me vlerë për Qeverinë	29.1	45,996	-	84,586
Depozitat e afatizuara në BQK	29.2	152,007	105,042	140,000
Depozitat e afatizuara në bankat komerciale	30	-	-	11,000
Fondet në banka komerciale	31	-	41	767
Paratë e gatshme në tranzit	32	5,115	7,074	4,278
Llogaritë e ambasadave të Republikës së Kosovës	33	448	961	526
Paratë e gatshme në dorë (arka)	34	907	1,184	885
Gjithsej pasuritë në para të gatshme		**278,171**	**203,629**	**290,838**
Bilancet e fondeve				
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	35	8,301	6,423	9,741
Të hyrat vetanake të bartura	36	33,832	29,284	29,691
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	37	10,676	-	-
Të tjera	38	9,215	7,924	7,295
		62,024	43,631	46,726
Të pashpërndara		216,147	159,998	244,111
Gjithsej Bilanci i Fondeve	27	**278,171**	**203,629**	**290,838**

Shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 1 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

1.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-048), të ndryshuar me Ligjin 03/L-221 dhe Ligjin 04/L-116 si dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme – *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme*. Shënimet e pasqyrave financiare formojnë pjesë përbërëse për kuptimin e pasqyrave dhe duhet të lexohen së bashku dhe në lidhje me pasqyrat.

1.2 Politikat e kontabilitetit

Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë së gatshme.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollon Thesari.

Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur janë nën kontroll të Qeverisë. Kjo do të thotë paratë të cilat janë transferuar në llogari të Thesarit në BQK, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e një organizate buxhetore në pritje për tu transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhen nga llogaria e vetme e Thesarit dhe shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve për udhëtime zyrtare njihen në momentin e arsyetimit të llogarisë së parave të imëta dhe udhëtimit zyrtar.

LMFPP ka disa kërkesa shtesë për prezantim të pasurive jofinanciare dhe detyrimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në pajtim me Pjesën 2 të SNKSP në bazë të parasë së gatshme. Pasuritë e prezantuara në aneksin 6 janë bazuar në shënimet e SIMFK, dhe përfshijnë pasuritë në vlerë mbi 1,000 Euro në pajtim me UA 2009/21.
Ndonëse zhvlerësimi nuk njihet si shpenzim në pajtim me bazën e raportimit sipas parasë së gatshme, lista e pasurive jofinanciare është paraqitur në vlerë neto, pas zbatimit të normave të zhvlerësimit sipas UA 2009/21.
Pasuritë me vlerë nën 1000 € janë paraqitur në aneksin 7, stoqet janë paraqitur në aneksin 8 edhe detyrimet e prezantuara janë paraqitur në aneksin 9 që të gjitha këto janë bazuar në pasqyrat financiare të deklaruara nga organizatat buxhetore.

Transaksionet ndërmjet organizatave buxhetore, të quajtura "Transaksionet ndërdepartamentale" nuk janë konsoliduar në këto pasqyra financiare, me qëllim që të ruhet konsistenca e informatave të raportuara me pasqyrat financiare individuale të organizatave buxhetore.

Shpenzimet janë kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik të Ligjit të Buxhetit, i bazuar në Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së (SFQ) që janë version i modifikuar i SFQ të bazuar në paranë e gatshme të vitit 1986 duke përfshirë elemente të SFQ 2001.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës.

1.3 Subjekti raportues

Pasqyrat financiare paraqesin aktivitetin financiar të Qeverisë së Republikës së Kosovës ashtu siç është specifikuar në Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin nr. 03/l-048 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-221 dhe Ligji nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Finanacave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/l-221 ku përfshihen të gjitha organizatat buxhetore:

(i) Ministritë,
(ii) Agjencitë,
(iii) Komunat.

1.4 Pagesat e bëra nga palët e treta

Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu përfiton nga mallërat dhe shërbimet si rezultat i pagesave të bëra nga palët e treta gjatë periudhës raportuese. Pagesat e bëra nga palët e treta nuk kosiderohen pranime ose pagesa në para të gatshme por janë përfitime të Qeverisë. Këto pagesa shpalosen në shtyllën *Pagesat nga palët e treta* të Pasqyrës së konsoliduar të pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.

1.5 Paratë e gatshme

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat kryesisht mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, banka komerciale dhe si parat e gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentet e parasë së gatshme.

1.6 Rikthimet e të dalave (pagesave) nga viti paraprak

Pagesar e kthyera në BRK nga vitet paraprake në vitin e tanishëm evidentohen si të hyra.

1.7 Valuta raportuese

Valuta raportuese është Euro (€)

1.8 Shumat raportuese

Shumat raportuese janë në njësi `000 (mijë) Euro (€) ,ndërsa tek anekset shumat janë në njësi Euro (€)

1.9 Data e autorizimit

Autorizohen me daten e nënshkrimit të deklaratës për Raportin Financiar nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Shënimi 2 Dogana

Të hyrat nga Dogana janë mbledhur në bazë të legjislacionit në fuqi. Të hyrat nga Dogana për vitin 2012 janë në shumë prej 844,861,000 Euro, ndërsa kthimet tatimore janë 2,074,000 Euro.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Akciza e jashtme në kufi	291,313	200,131	157,940
Taksa doganore në import, cigare, etj	-	84,424	74,696
Akciza e brendshme	11,889	-	-
Taksa doganore në importe	117,721	121,211	104,100
Tatimi në vlerën e shtuar (TVSH) në kufi	418,927	419,485	361,321
Te hyrat nga denimet	438	982	1,055
Shitja e mallërave	401	540	407
Tatimet tjera doganore	3,416	255	595
Komp e demeve nga komp siguri	-	20	-
Banderollat	459	434	380
Kontrolla e jashtme doganore	263	144	100
Fast-Dogana	34	78	63
Pranimet	**844,861**	**827,704**	**700,657**
Kthimi i TVSH-së	(1,063)	(706)	(624)
Kthimet e akcizes	(184)	(131)	(320)
Kthimet doganore	(486)	(238)	(245)
Kthimi i taksave të ndryshme doganore	(341)	(37)	(82)
Kthimet	**(2,074)**	**(1,112)**	**(1,272)**
Neto Pranimet	**842,787**	**826,592**	**699,385**

Shënimi 3 Administrata Tatimore e Kosovës

Të hyrat nga ATK janë mbledhur në bazë të legjislacionit në fuqi. Të hyrat nga ATK-ja për vitin 2012 janë në shumë prej 283,915,000 Euro , ndërsa kthimet tatimore janë 32,763,000 Euro.

Përshkrimi	Shënim	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Tatimi i paragjykuar	3.1	405	869	284
Tatimi në fitim	3.2	116	1,798	583
Tatimi i korporatave	3.3	62,681	54,564	51,946
Tatimi në të ardhurat personale	3.4	60,089	55,668	44,232
Tatimi mbi vlerën e shtuar	3.5	129,581	121,439	95,008
Tatimi për bizneset individuale		25,932	23,517	25,467
Tatimi në interes, dividentë, qira, lojëra të fatit		1,631	1,376	1,533
TVSH e shtyrë		379	-	-
Tatimet e paspecifikuara		62	37	734
Të hyrat nga gjobat e ATK-së		2,376	583	25
Licenca për lojëra		659	1,284	1,424
Të hyrat nga shitja e mbeturinave		3	-	-
Pranimet		**283,915**	**261,134**	**221,234**
Ktimet e tatimit ne te ardhura personale		(251)	(179)	-
Kthimi i tatimit per biznese		(31)	(111)	-
Kthimimet nga qiraja, fitimet. Lojrat		-	(242)	-
Kthimi i tatimit per korporata		(1,432)	(2,120)	-
Kthimet e tatimit mbi vlerën e shtuar		(31,049)	(27,122)	(27,017)
Kthimet		**(32,763)**	**(29,774)**	**(27,017)**
Neto Pranimet		**251,151**	**231,360**	**194,218**

3.1 Tatimi i paragjykuar

Tatimi i paragjykuar i mbledhur gjatë vitit 2012 është në shumën prej 405,000 Euro.

3.2 Tatimi në fitim

Në pajtim me legjislacionin në fuqi ATK-ja ka grumbulluar këtë lloj tatimi.Të hyrat nga tatimi në fitim për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012, janë në shumë prej 116,000 Euro.

3.3 Tatimi për korporata

Në pajtim me legjislacionin në fuqi ATK-ja ka grumbulluar tatimin në korporata, shuma e pranuar gjatë vitit 2012 është 62,681,000 Euro.

3.4 Tatimi në të ardhurat personale

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, ATK-ja ka grumbulluar këtë lloj tatimi në shumën prej 60,089,000 Euro gjatë vitit 2012.

3.5 Tatimi mbi vlerën e shtuar – TVSH

Të hyrat nga TVSH-ja e brendshme për vitin 2012 janë në shumën prej 129,581,000 Euro. Kjo shumë ka të bëjë me TVSH-në të grumbulluar në vend nga ATK-ja sepse TVSH-ja në importe përfshihet brenda të hyrave nga taksat doganore (shih shënimin 2).

Shënimi 4 Të hyrat vetanake të komunave

Të hyrat komunale përbëhen nga të gjitha të hyrat vetanake të cilat mblidhen përmes aktiviteteve të ushtruara nga të gjitha komunat. Të hyrat e dhëna më poshtë përfshijnë të hyrat nga gjobat pasi që ato evidentohen si të hyra jotatimore të nivelit qëndror dhe më vonë i alokohen komunave.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Drenas	868	837	771
Fushë Kosovë	1,647	1,434	1,260
Lipjan	1,111	1,570	1,487
Obiliq	622	624	642
Podujevë	1,137	1,044	1,123
Prishtinë	23,160	18,810	18,747
Shtime	271	346	317
Graçanicë	1,386	1,122	335
Dragash	365	392	397
Prizren	4,340	4,999	4,434
Rahovec	800	887	781
Suharekë	2,906	1,635	1,584
Malishevë	844	599	649
Mamushë	43	42	41
Deçan	465	573	422
Gjakovë	2,778	2,382	2,395
Istog	765	809	715
Klinë	719	719	729
Pejë	2,860	2,604	2,532
Junik	79	76	73
Leposaviq	4	0	10
Mitrovicë	1,544	1,834	1,851
Skenderaj	571	1,212	1,024
Vushtrri	1,158	1,241	1,091
Zubin Potok	0	-	8
Zveçan	1	0	-
Z.A.Mitrovica Veriore	0	-	-
Gjilan	3,177	3,525	3,121
Kaqanik	426	510	515
Kamenicë	736	797	699
Novo Berdo	169	99	43
Shterpc	232	237	114
Ferizaj	3,160	3,415	3,024
Viti	694	783	802
Partesh	24	14	-
Hani i Elezit	231	303	215
Kllokot	74	68	30
Ranillugë	80	78	44
Gjithsej	**59,448**	**55,621**	**52,028**

Shënimi 5 Të hyrat vetanake të organizatave qendrore buxhetore

Përfshijnë të hyrat të cilat grumbullohen duke u bazuar në ligjin e buxhetit dhe në marrëveshjet e mirëkuptimit. Shuma totale e këtyre pranimeve gjatë vitit 2012 është 44,835,000 Euro.

Përshkrimi	Shenim	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Të hyrat nga taksat administrative		4,941	7,850	5,591
Të hyrat nga gjobat- denimet		3,297	2,794	2,058
Të hyrat nga licencat	5.1	15,846	29,062	20,823
Të hyrat nga shërbimet/pasuria		1,129	1,905	2,724
Të hyrat nga participimet	5.2	14,025	13,432	11,918
Të hyrat nga inspektimi		5,537	4,846	5,315
Të hyrat nga pasuria		20	-	-
Të hyrat nga qiraja për objektet publike		-	24	24
Pranimet tjera		40	-	-
Gjithsej		**44,835**	**59,912**	**48,451**

Shënimi 5.1 Të hyrat nga licencat

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Ministria e bujqësisë,pylltarisë she zhvillimit rural	1,462	1,336	825
Ministria e tregtisë dhe industrisë	560	30	-
Ministria e shëndetësisë	1,682	1,516	1,473
Ministria e drejtësisë	20	37	76
Ministria e Arsimit shkencës dhe teknologjisë	78	103	81
Autoriteti rregullativ i telekomunikacionit	5,343	18,006	9,393
Zyra rregullative e energjisë	590	509	550
Autoriteti i aviacionit civil	9	3	-
Komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve	5,887	7,267	8,205
Komisiioni i pavarur për media	215	256	219
Gjithsej	**15,846**	**29,062**	**20,823**

Shënimi 5.2 Të hyrat nga participimet

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Ministria e shëndetësisë	1,679	1,732	1,689
Ministria e kulturës rinisë dhe sportit	25	22	22
Ministria e arsimit shkencës dhe teknologjisë	2,413	2,040	1,716
Universiteti i Prishtinës	9,907	9,638	8,491
Gjithsej	**14,025**	**13,432**	**11,918**

Shënimi 6 Të hyrat e dedikuara të AKP-së

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	16,248	0	0
Gjithsej	**16,248**	**0**	**0**

Shënimi 7 Grantet e përcaktuara të donatorëve

Grantet pranohen prej donatorëve të ndryshëm të cilët në mënyrë specifike tregojnë qëllimin e shfrytëzimit. Në vijim janë detajet e të hyrave të vitit 2012 sipas donatorëve.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Grantet e brendshme*	1,493	1,116	1,618
Procredit bank	-	1	1
Grante tjera të jashtme	1	-	-
Teb bank	0	-	-
Kryqi i Kuq	5	-	4
Banka Botërore	2,657	2,307	2,770
Qeveria e Austrisë	-	10	31
Qeveria Britaneze	1,068	182	720
Save the Children	50	-	15
Qeveria Daneze	327	392	500
Qeveria Holandeze	-	58	54
Unioni Europian	99	997	2,609
Qeveria Gjermane	14	34	21
Qeveria Finlandeze	9	4	-
Qveria Italiane	1,178	35	90
Qeveria e Luksemburgut	102	100	
Qeveria Norvegjeze	705	563	192
Qveria Zvicerrane	1,147	876	758
Qeveria Suedeze	7	12	27
Qeveria Turke	-	25	-
Qeveria Greke	27	-	-
Qeveria Kroate	9	-	-
Kombet e Bashkuara	31	-	-
Internaci.civil.office-ICO	-	-	205
UNDP	264	161	1,397
UNOPS	-	133	-
UNICEF	65	106	188
USA	243	283	9
GTZ	43	51	70
OSCE	5	-	-
SIDA	-	80	158
UNMIK	-	-	11
GLOBAL FUND	37	44	1,469
Qeveria e Belgjikes	14	-	68
Organanizata botërore e shëndetsisë	10	16	16
Council of Europe	1,202	587	1,944
Qeveria e Shqiperise	56	265	80
Republika Qeke	9	20	26
TEMPUS	111	171	37
Kosovo AID and Development-KAD	119	-	-
KFOR-I Hungarez	-	-	25
Un-Habitati	178	146	102
Pranimet tjera	37	194	127
Gjithsej	**11,322**	**8,968**	**15,342**
Interesi nga grantet		-	-
Gjithsej grantet e përcaktuara nga donatorët	**11,322**	**8,968**	**15,342**

(*) Janë participime të qytetarëve për bashkëfinancim të projekteve të ndryshme.

Shënimi 8 Grantet për përkrahje të buxhetit

Në vitin 2012 është pranuar një shumë prej 37,417,000 Euro si mbështetje buxhetit nga Banka Botërore

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Komisioni Evropian	-	-	30,000
Banka Botërore	37,417	19,240	-
Gjithsej	**37,417**	**19,240**	**30,000**

Shënimi 9 Huazimet e Jashtëme

Janë pranime të cilat kanë ardhur nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Huamarrjet nga IFN-të	96,635	5,076	22,093
Transfer për FSDK	(2,958)	-	-
Gjithsej	**93,677**	**5,076**	**22,093**

Shënimi 10 Huazimet e Brendëshme-Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë

Gjatë vitit 2012 për herë të parë Ministria e Financave ka filluar emetimin e Letrave me vlerë.Në vitin 2012 , në emër të letrave me vlerë është pranuar shuma prej 73,313,000 Euro.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë	73,313	-	-
Gjithsej	**73,313**	**-**	**-**

Shënimi 11 Depozitat

Janë të hyra të cilat mbahen në mirëbesim në emër të palëve të treta dhe ruhen si të tilla deri në përcaktimin e definimit të tyre. Këto të hyra mbahen në llogaritë e Fondit të konsoliduar të Kosovës.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Depozitat e lojërave të fatit	144.69	147.86	150.00
Depozitat e komisionit rregullativ	-	-	37.47
Depozitat nga sekuestrimet	271.19	26.41	-
Depozitat-organi shqyrtu.prok.	95.61	117.50	-
Depozitat e DAGJ-it	258.12	251.73	294.37
Depozitat e dhomës speciale	7.75	9.90	8.92
Depozitat e të Burgosurve	68.39	30.66	-
Pagat e minoriteteve në mirëbesim	398.19	-	-
Agjensioni Kosovar i Pronave	76.26	54.44	62.81
AKP -renta për inventarin	2.10	2.73	22.79
Depoitat për shpronësim-Komunat	-	197.98	-
Gjithsej	**1,338**	**957**	**577**

Shënimi 12 Gjobat dhe tarifat

Grumbullohen nga organizatat buxhetore të nivelit qëndror, shuma totale e të cilave gjatë vitit 2012 është 39,845,000 Euro.

Përshkrimi	Shënim	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Të hyrat nga taksat administrative	12.1	34,513	37,664	30,027
Të hyrat nga gjobat- denimet		292	608	386
Të hyrat nga licencat		1,375	1,871	2,068
Të hyrat nga shërbimet/pasuria		937	754	784
Te hyrat nga licencat ne sektorin e naftes		344	410	-
Të hyrat nga koncesionimi i Aeroportit		2,000	2,000	-
Të hyrat nga inspektimi		-	-	3
Tarifa per akreditim		15	8	-
Te hyrat nga pasuria		22	49	-
Praimet tjera		142	29	-
Të hyrat nga qiraja për objektet publike		-	-	16
Të hyrat tjera jo tatimore		-	-	54
Të hyrat ndërdepartamentale		205	-	-
Gjithsej		**39,845**	**43,393**	**33,337**

Shënimi 12.1 Taksat administrative

Taksat administrative të pranuara gjatë vitit fiskal 2012 janë në shumë 34,513,000 Euro, dhe janë dhënë në detaje në tabelën në vijim.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Taksat e regjistrimit te automjeteve	10,227	14,601	7,017
Taksat rrugore	11,454	11,787	10,401
Taksat per dokumente te udhetimiit	7,287	5,604	6,346
Taksat per letërnjoftim	932	895	1,151
Taksat për leje të vozitjes	2,354	2,527	3,194
Taksat komunale për leje ndërtimi	2	-	
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	928	854	802
Taksat administrative për fletëkërkesë	-	466	169
Pjesëmarrja në tender	8	34	46
Taksat për shtetësi	749	872	881
Taksat për mbrojtje nga zjarri	17	21	18
Taksat për certifikatat e lindjes	13	-	-
Certifikatat e kurorëzimit	3	2	-
Taksat për certifikatat e vdekjes	0	-	-
Taksat tjera administrative	497	-	-
Taksat për armë	31	-	-
Taksat për leje urbanistike	4	-	-
Taksat për përdorim civil të eksplozivit	5	-	-
Gjithsej	**34,513**	**37,664**	**30,027**

Shënimi 13 Interesi

Të hyrat nga interesat janë inkasuar në llogaritë e BQK-së, nga investimi i parasë publike dhe nga huazimet. Paratë publike kanë filluar të investohen në muajin qershor 2007. Interesat për llogaritë bankare dhe investimet janë të shpalosura në tabelën në vijim.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Interesi bankar	0	-	0
Interesi për kredinë e dhënë KEK-ut	-	-	5,371
Interesi i akumuluar i Thesarit	0	1,631	6,346
Gjithsej	**0**	**1,631**	**11,718**

Shënimi 14 Dividentat

Në bazë të vendimeve 03/62 dhe 09/89 të Qeverisë së Kosovës, PTK ka deklaruar dividendën prej 45,000,000 Euro që i është paguar aksionarit të vetëm, Qeverisë së Kosovës. Në vitin 2012 janë pranuar 45 milion Euro nga PTK-jaDividendat e pranuara janë paraqitur si pozicion i veçantë i pranimeve.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Dividenta e PTK-së	45,000	55,000	80,000
Dividenta e Airoportit	0	5,000	5,000
Gjithsej	**45,000**	**60,000**	**85,000**

Shënimi 15 Financimi i njëhershëm i AKP-së

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Financimi i njëherëshëm i AKP-së	28,934	-	-
Gjithsej	**28,934**	**-**	**-**

Shënimi 16 Kthimi i huadhënjeve nga Ndërmarrjet Publike

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Kthimi i huadhënjeve nga NP	4,000	-	-
Gjithsej	**4,000**	**-**	**-**

Shënimi 17 Të hyrat tjera

Janë të hyra cilat janë pranuar në llogarinë kryesore të Thesarit dhe janë në shumën prej 1,300,000 Euro.

Përshkrimi		2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Të hyrat nga viti i kaluar	17.1	942	427	1,044
Kthim i avanceve nga viti i kaluar		8	30	27
Kthimi I fondeve nga ndërmarrjet publike		-	-	686
Pagesat e kthyera nga KEK-u		-	-	588
Kompenzimi i dëmeve nga sigurimi		-	-	12
Llogaria për mosbarazim		0	-	-
Diferenca në kusin valutor		1	2	-
Pranimet-Nënhuazimet		348	43	-
Gjithsej		**1,300**	**502**	**2,358**

Shënimi 17.1 Të hyrat nga viti i kaluar

Në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, shpenzimet nga vitet e mëparshme, të cilat kthehen në BRK regjistrohen si të hyra në vitin e tanishëm dhe jo si zvogëlim i shpenzimeve. Shuma prej 942,000 Euro, janë avanse të kthyera dhe pagesa tjera të vitit paraprak nga, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Policia e Kosovës, Komuna e Skenderajt , Ministria e kthimit dhe komuniteteve etj.

Shënimi 18 Rroga dhe Paga

Pagat dhe meditjet gjatë vitit 2012 janë në shumë prej 409,245,000 Euro. Kjo ka përfshirë 407,706,000 Euro nga fondi i përgjithshëm dhe 1,539,000 Euro nga grantet e përcaktuara të donatorëve, në vazhdim mund të shihni pagesat sipas secilës kategori ekonomike.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Pagesat nga BKK			
Pagat neto	349,095	331,032	268,499
Tatimi në të ardhura personale	18,394	16,876	11,572
Kontributi pensional i punëmarrësit	19,391	18,283	14,776
Total pagat bruto	**386,880**	**366,191**	**294,847**
Kontributi pensional i punëdhënësit	19,439	18,402	14,945
Pagesa e BSPK -0.10% te 0.50%	1,210	-	920
Pagat për punë jashtë orarit (*)	-	6	75
Meditjet e delegatëve dhe komisioneve në Kuvend	-	2	58
Pagat me kontratë	178	423	560
Vendimet gjyqësore	-	10	11
	407,706	**385,033**	**311,417**
Pagesat nga Grantet			
Pagat neto	960	2,123	2,987
Tatimi në të ardhura personale	116	262	363
Kontributi pensional i punëmarrësit	66	144	230
Kontributi pensional i punëdhënësit	23	38	53
Pagat për punë jashtë orarit	8	-	4
Punt.me kont(jo në list.e pag)	367	701	1,147
Meditjet e delegatëve dhe komisioneve në Kuvend	-	1	-
	1,539	**3,270**	**4,783**
Gjithsej	**409,245**	**388,303**	**316,200**

Shënim: (*) Në kategorinë Pagat për punë jashtë orarit bëjnë pjesë: pagat sekondare, kujdestaritë, pagesat e komisioneve, puna jashtë orarit, stimulimet për punëtorë.

Shënimi 19 Mallra dhe shërbime

Mallërat dhe shërbimet e paguara gjatë vitit 2012 janë në shumën prej 172,482,000 Euro. Kjo ka përfshirë 169,362,000 Euro nga fondi i përgjithshëm dhe 3,120,000 Euro nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Në këtë shpalosje nuk janë të përfshira shpenzimet nga pagesat direkte të Bankës Botërore .

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Pagesat nga BKK			
Shpenzimet e udhëtimit	10,455	8,168	7,684
Shërbimet e telekomunikimit	4,484	3,973	3,798
Shërbimet kontraktuese (*)	35,073	29,234	33,443
Mobilje dhe paisje	5,697	6,810	7,396
Furnizime(**)	46,718	44,937	44,886
Derivate dhe lëndë djegëse	26,159	23,001	18,572
Avanse	(2)	(0)	761
Shërbimet financiare	241	206	426
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimit	3,827	3,298	2,998
Mirëmbajtja dhe riparimi (***)	22,637	23,642	27,532
Qiraja	6,891	6,400	6,498
Shpenzimet e marketingut	2,782	3,218	5,082
Shpenzimet e përfaqsimit	3,321	2,772	2,669
Vendimet gjyqësore	1,052	887	860
Mungesa në arkë	2	1	1
Tatimi	23	12	5
Servisimi i Borxhit	-	-	26
	169,362	**156,559**	**162,635**
Pagesat nga Grantet			
Shpenzimet e udhëtimit	211	344	363
Shërbimet e telekomunikimit	32	61	52
Shërbimet kontraktuese	1,394	2,716	2,337
Mobilje dhe paisje	672	896	492
Blerje tjera mallra dhe sherbime	183	382	432
Derivate dhe lëndë djegëse	24	52	21
Avanse	460	396	568
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimit	4	10	13
Mirëmbajtja dhe riparimi	24	41	49
Qiraja	16	54	60
Shpenzimet e marketingut	54	49	83
Shpenzimet e përfaqsimit	47	28	48
Tatimi	-	3	0
Vendimet e gjykatave	-	0	3
	3,120	**5,033**	**4,521**
Gjithsej	**172,482**	**161,591**	**167,156**

Shënim: (*) në kategorinë shpenzimet kontraktuese bëjnë pjesë: shërbimet e arsimit dhe trajnimit, shërbimet e perfaqesimit dhe avokaturës,shërbimet e ndryshme shëndetsore, shërbimet këshilldhënëse,shërbime për shtypje,mirëmbajtje e softëverit, kompensimi për vendimet gjyqësore etj.

(**) në kategorinë furnizime bëjnë pjesë: shpenzimet për furnizime mjeksore, furnizime pastrimi, akomodimi, furnizim me municion dhe armë zjarri, furnizim me ushqim dhe pije, furnizim për zyre, shpenzimet për statusin, blerja e bllombave, banderolat.

(***) në kategorinë mirëmbajtja dhe riparimi bëjnë pjesë: mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e infrastruktures rrugore, mirëmbajtja TI-së, mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve etj.

Shënimi 20 Shpenzimet për shërbimet komunale

Shpenzimet komunale të paguara gjatë vitit 2012 janë në shumë prej 21,560,000 Euro. Këtu përfshihen 21,558,000 Euro nga fondi i përgjithshëm dhe 3,000 Euro nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Pagesat nga BKK			
Energjia elektrike	12,259	10,790	9,416
Uji	3,524	3,262	3,316
Mbeturinat	1,577	2,075	2,391
Ngrohja qëndrore	1,506	1,101	1,733
Telefoni	2,552	2,432	2,627
Vendime gjyqësore	139	716	32
	21,558	**20,376**	**19,516**
Pagesat nga Grantet			
Energjia elektrike	2	1	1
Uji	-	1	0
Telefoni	0	7	10
Mbeturinat	-	4	
	3	**12**	**12**
Gjithsej	**21,560**	**20,388**	**19,527**

Shënimi 21 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet dhe transferet e paguara gjatë vitit 2012 janë në shumën prej 280,317,000 Euro duke përfshirë 280,120,000 Euro nga fondi i përgjithshëm dhe 197,000 Euro nga grantet e përcaktuara të donatorëve e që mund të shihen në tabelën në vijim.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Pagesat nga BKK			
Subvencione për ndërmarrjet publike	52,184	60,487	56,428
Subvencione për entitete publike kulturore	1,938	1,999	2,758
Subvencione për entitete jo-publike	27,321	17,209	21,481
Transfere për Qeveri tjera	1,700	8	1,316
Pagesat per përfituesit individual	10,193	9,934	8,317
Pensionet bazë	111,857	93,465	95,031
Pensionet për personat me aftësi të kufizuar	11,610	11,107	11,499
Ndihmat sociale	27,461	28,305	28,623
Pensionet e TMK-së	1,499	1,021	903
Pagesat për invalidët e luftës	30,865	29,243	23,508
Pagesat për familjet e viktimave të luftës	37	66	64
Pensionet për punonjësit e Trepçës	3,193	3,128	2,464
Vendimet gjyqësore	262	194	288
	280,120	**256,166**	**252,679**
Pagesat nga grantet			
Subvencione për entitete publike kulturore	-	-	4
Subvencione për entitete publike	100	110	101
Subvencione për entitete jo-publike	40	161	586
Pagesat për përfituesit individual	58	40	113
	197	**310**	**805**
Gjithsej	**280,317**	**256,476**	**253,484**

Shënimi 22 Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale gjatë vitit 2012 janë në shumë prej 554,813,000 Euro, duke përfshirë 550,245,000 Euro nga fondi i përgjithshëm dhe 4,568,000 Euro nga grantet e përcaktuara të donatorëve që mund të shihen në tabelën në vijim të ndara sipas kategorive ekonomike.

Përshkrimi	2012 € '000	2011 € '000	2010 € '000
Pagesat nga BKK			
Ndërtesat	66,556	68,497	69,550
Ndërtimi i rrugëve	338,317	345,302	260,999
Energji elektrike, gjenerimi dhe transmisioni	993	968	2,297
Pajisjet e TI-së	21,867	18,697	26,624
Automjete transporti	9,433	4,641	7,155
Makineri	381	424	1,342
Kapital tjetër (*)	52,892	49,745	54,132
Pasuritëe paprekshme	726	1,052	
Tokë	43,012	23,696	15,563
Transferet kapitale - ndermarrjet publike	10,411	12,835	14,656
Transferet kapitale - ndermarrjet jopublike	3,220	1,169	2,637
Vendimet gjyqësore	2,437	1,160	389
	550,245	**528,186**	**455,344**
Pagesat nga Grantet			
Ndërtesat	1,502	1,347	1,830
Ndërtimi i rrugëve	1,152	694	935
Energji elektrike, gjenerimi dhe transmisioni	28	0	29
Pajisjet e tekn.inf(sist.vle>1000)	357	271	652
Automjete transporti	12	55	42
Tokë	-	7	10
Makineri	-	-	17
Kapital tjetër	1,200	608	399
Transferet kapitale -Subjektet jopublike	316.27	121	15
	4,568	**3,104**	**3,929**
Gjithsej	**554,813**	**531,290**	**459,272**

Shënim: (*) në kategorinë kapital tjetër bëjnë pjesë shpenzimet për mjete pune, riparime dhe renovime të ndërtesave, paisje për miniera, shpenzimet për pyllëzim, blerja e kompjuterve, zhvillimi i softverëve etj.

Shënimi 23 Pagesat e borxhit

Në vitin 2012 janë bërë pagesa të borxhit qeveritar në shumë prej 21,416,000 Euro. Një tabelë me të dhëna të detajuara është dhënë më poshtë:

Borxhi i konsoliduar

Pagesat	**2012**	**2011**	**2010**
	€ '000	**€ '000**	**€ '000**
Kryegjëja	11,337	6,839	5,669
Interesi	9,260	4,547	4,414
Taksa dhe tarifa tjera	819	105	-
Gjithsej pagesa nga BRK-ja	**21,416**	**11,491**	**10,083**
Pagesa nga Qeveria Amerikane	-	8,755	9,787
Pagesa nga Komisioni Evropian	-		-
Pagesa nga Qeveria Zvicrrane	-	527	
Gjithsej pagesa nga donatorët	**-**	**9,282**	**9,787**

*Shenim : Është perfshire edhe interesi i paguar për letra me vlerë në shumë prej 659,874.08 Euro

Shënimi 24 Huazimet për ndërmarrjet publike

Në bazë të marrëveshjeve të kredisë ndërmjet KEK-ut dhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, gjatë vitit 2012 janë bërë pagesa të kredisë dhënë KEK-ut në shumë totale prej 15,000,000 Euro, për më shumë informata shih Aneksin 5.

Shënimi 25 Pagesat për anëtarësim në IFN

Në bazë të vendimit 05/103 Qeverisë së Kosovës, për vitin 2012 ndahen mjete financiare në vlerë prej 1,050,000 Euro për anëtarësim në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Anëtarësimi në Institucionet Financiare Ndërkombëtare

	2012	**2011**	**2010**
	€ '001	**€ '000**	**€ '000**
Fondi Monetar Ndërkombëtar	0	-	169
Antarësimi në BERZH	1,050	-	-
Gjithsej e paguar nga BRK	**1,050**	**-**	**169**

Shënimi 26 Kthimet e Fondeve të Depozitave

Në vazhdim është një përmbledhje e fondeve të cilat janë kthyer gjatë vitit 2012. Këto pagesa nuk merren parasysh në procesin e ndarjeve buxhetore pasi që ato janë kthime të fondeve të cilat mbahen në mirëbesim. Totali i fondeve të kthyera është 190,000 Euro.

Përshkrimi	2012 € '000	2011 € '000	2010 € '000
Depozitat e organit shqyrtus të prokurimit	-	-	4
Detyrimet për pagesat gabim	-	-	2
Depozitat e të burgosurve	-	-	13
Depozitat në mirëbesim- pagat e minoriteteve	-	48	1,102
Depozitat-kthim i pagave	54	22	-
Depozitat e subjekteve politike	-	286	-
Depozitat e Agjencionit Kosovar te Prones	1	10	17
Depozitat e Shpronsimit - Komunat	118	-	-
Depozitat nga Zyra Zvicrrane	-	-	380
Kthimet e donacioneve	18	556	114
Gjithsej	**190**	**922**	**1,632**

Shënimi 27 Para të gatshme

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat kryesisht mbahen në Bankën Qëndrore të Kosovës, banka komerciale, para të gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentet e parasë. Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe bilancet e fondeve thekson kategoritë kryesore të pasurive në para të gatshme të cilat menaxhohen nga Qeveria dhe hollësitë në lidhje me bilancet e tilla janë dhënë në shënimet 25 deri 30.

Në kuadër të këtyre fondeve bëjnë pjesë fondet e ndara për qëllime specifike, në të cilat përfshihen fondet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat vetanake të bartura dhe fondet në mirëbesim. Këto bilance të parave të gatshme janë detaizuar në shënimet 34, 35, 36 dhe 37 dhe si përmbledhje janë të dhëna në tabelen në vijim.

Përshkrimi	2012 '000 €	2011 '000 €	2010 '000 €
Totali i fondeve	278,171	203,629	290,838
Fondet e pashpërndara	(216,147)	(159,998)	(244,111)
Fondet e përcaktuara	**62,024**	**43,631**	**46,726**
Fondet e përcaktuara			
Fondi i granteve të përcaktuara të donatorëve	8,301	6,423	9,741
Të hyrat vetanake të bartura	33,832	29,284	29,691
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	10,676	-	-
Të tjera	9,215	7,924	7,295
	62,024	**43,631**	**46,726**

Shënimi 28 Krahasimet buxhetore

Gjatë vitit janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore. Këto rregullime janë të bazuara në autorizimet ligjore që jepen në LMFPP dhe janë të përshkruara në raportin e buxhetit dhe aneksin 1 dhe 2.

Në raportin e buxhetit nuk janë përfshirë të hyrat dhe të dalat nga grantet e përcaktuara.

Shënimi 29 Fondet në Bankën Qendrore të Kosovës

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LlVTh). Pjesa dërmuese e llogarive mbahen në Bankën Qëndrore të Kosovës (BQK). Në vijim është lista e llogarive të mbajtura në BQK.

Numri i llogarise	Emri i llogarise	2012 `000 Euro	2011 `000 Euro	2010 `000 Euro
`1000400070000180	Llogaria kryesore - BK	60,694	83,058	44,459
`1000400070004642	AKP Privatizimi Tarifa Adm.	8,048	1,802	-
`1000430070003622	Pensionet dhe skemat sociale	2,226	1,698	1,562
`1000430070008084	Pagat e minoriteteve ne mirebesim	1,660	1,299	1,416
`1000400070003284	Gjobat ndaj institucioneve financiare	-	220	124
`1000430070008472	KPA Kosovo Property Agency	252	197	142
`1000430070008763	KPA Inventory Rents	192	190	188
`1000400070003187	Ministria e FSK	-	153	153
`1000430070000227	Pagat e sherbyesve civil	146	153	118
`1000400070004448	Fondet ne mirebesim KK Prishtine	45	139	-
`1000430070008569	KPA Depozitat	129	129	140
`1000430070007017	Fondet ne mirebesim - QK Dubrave	165	121	103
`1000400070004836	Fondet ne mirebesim KK Skenderaj	0	59	-
`1000430070007308	Qendra e paraburgimit - Lipjan	31	20	17
`1000400070003769	Agjencioni per administrimin e pasurise se sekuestruar ose konfiskuar	0	18	-
`1000400070004254	Prokurori i Shtetit	-	14	-
`1000400070005321	FSR AE likuiditeti i sistemit fin.	5	-	-
`1000430070007793	Qendra e paraburgimit - Prishtine	13	12	10
`1000430070007114	Qendra e paraburgimit - Prizren	12	11	11
`1000430070007405	Fondet ne mirebesim - QK Lipjan	14	9	8
`1000430070007502	Qendra e paraburgimit - Peje	8	8	8
`1000430070007211	Qendra e paraburgimit - Gjilan	6	6	3
`1000430070007987	Fondet ne mirebesim QK Smrekovnice	10	5	5
`1000430070007696	Qendra e paraburgimit - Mitrovice	6	4	2
`1000400070003575	Fondet ne mirebesim nga shpronesimi	35	-	-
`1000400070005418	Zyra Administrative Mitrovice Veriore	0	-	-
`1000400070004739	Akademia e Shkences dhe Arteve RK	-	0	-
`1000650220000046	Komuna e Podujeves	-	0	-
`1000650150000190	Komuna e Lipjanit	-	0	-
Llogarit rrjedhëse		**73,697**	**89,326**	**48,796**
`1000400071000357	Letrat me vlerë	45,996	-	84,586
